



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA		
Komuna Junik - Opština Junik		
0294. Fort.	Nri faq	Data
4-06-9473	2	29.12.2016



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

Datë: 29.12.2016

Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-44 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, në Nenin 8 Pika 5 dhe 6 e këtij ligji precizon Përgjegjësitë e Komunës për njoftimin publik, për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, Rregullorja QRK nr. 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës dhe Vendimin e Kuvendit të Komunës me numër 02/107 të datës 23.06.2016 për miratim paraprak të pronës së paluajtshme komunale shpall:

NJOFTIM PUBLIK

Për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim

1.	Emërtimi i pronës, lokacioni dhe përshkrimi i saj	<ul style="list-style-type: none">- Parcelat kadastrale me numër 1563-2 dhe 1564 në sipërfaqe të përgjithshme prej 4732 m² në vendin e quajtur Pepsh-Varrezat e Gacaferit, kultura: Tokë bujqësore, shfrytëzimi aktual: Kullosë.- Parcelat kadastrale janë pronë komunale dhe evidentohen në Certifikatat e pronësisë me numër: P-73105038 dhe P-73105038-01564-2.
2.	Kohëzgjatja e shfrytëzimit	<ul style="list-style-type: none">- 99 Vite
3.	Cfardo kushti apo kufizimi mbi dhënien e të drejtave në shfrytëzim	<ul style="list-style-type: none">- Plani i biznesit për minimum 5 Vitet e ardhshme,- Fillimi i aktiviteteve brenda 6 muajve të parë,- Punësimi i 10 punëtorve minimum dhe përfshirja e stafit aktual prej 7 punëtorve,- Mos-zvogëlimi i stafit aktual nga puna (7 punëtor),- Investime në vitin e parë minimum 1 milion euro,- Dëshmi që nuk ka borgje ndaj Komunës apo ATK-së,- Dëshmi mbi kontratat e lidhura më herët me operatorët e huaj.
4.	Shfrytëzimin e lejuar të tokës	<ul style="list-style-type: none">- Në hapësirat e ofruara për shfrytëzim, veprimtarise aktuale nuk lejohet t'i ndrrohet destinimi asnjëherë, ndërsa në hapësirën përcjellëse të ofruar për shfrytëzim mund të zhvillohet çdo veprimtari afariste e cila nuk cenon rendin publik, mbrojtjen e shëndetit publik, mjedisin, florën dhe faunen dhe pasuritë kombëtare të Kosovës dhe që nuk bie në kundërshtim me

		legjislacionin në fuqi.
5.	Formën e Konkurrimit	- Ankand me hapje publike të ofertave
6.	Cmimi fillestar	- 200 Euro për një vit
7.	Kërkesat për pjesëmarrje në konkurrim	- Certifikata e regjistrimit të biznesit në Kosovë dhe jashtë Kosovës, - Referencat e punës, - Qarkullimi vjetor bankar - Plani i biznesit për minimum 5 vite.
8.	Procedurat e regjistrimit të ofertuesve	- Ofertuesit mund të aplikojnë nga data e publikimit për 45 ditë kalendarike. Materiali dorëzohet në Zyrën e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Junikut. Poashtu konkursin mund ta gjeni në web-faqen zyrtare: http://kk.rks-gov.net/junik .
9.	Koha dhe vendi ku mbahet ankandi, hapja e ofertave	- Ankandi mbahet më datën 13.02.2017 në ora 14:00, Objekti i Komunës së Junikut, Zyra e Nënkyetarit të Komunës.

Dokumentet e nevojshme për konkurrim:

- Certifikata e regjistrimit të biznesit
- Referencat e punës,
- Plani i biznesit i cili duhet të përmbajë: Fillimi i aktiviteteve brenda 6 muajve, Punësimi i 10 punëtorve minimum, Investime 1 milion euro , dhe planin e rrjedhes së pasqerë minimum për 5 vite.

Kriteret për zgjedhjen e ofertave sipas Nenit 13 të rregullores QRK nr.23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës:

- Oferta ekonomikisht më e favorshme
- Vlera e investimit
- Numri i të punësuarve nga investimi
- Lloji i investimit që është interes publik për Komunën
- Kriteret të tjera që mund të përcaktohen me Konkurs.

Kryesuesi i Komisionit

Leonard Llojani

